

Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2026

Në mbështetje të nenit 158, pika 3, gërma “a”, dhe “ë” të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar); politikën e burimeve njerëzore në KESH sh.a, Shoqëria KESH sh.a shpall konkursin për vend të lirë pune “Specialist”, në Auditin e Brendshëm.

### ***Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme të pranimit në punë***

#### **Kualifikimi Minimal / Kompetencat**

- Diplomë Universitare të ciklit të dytë të studimeve në shkencat ekonomike, juridike, apo disiplina të tjera, sipas nevojave të auditimeve në KESH SHA;
- Të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- Të jetë i certifikuar si "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik";
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të përdorë lirisht programet në kompjuter;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe koordinuese.

#### **Përshkrimi i punës**

#### **Përgjegjësitë kryesore:**

- Departamenti i Auditit të Brendshëm ka për detyrë:
- Të ushtrojë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrdhënieve të ndërsjella të këshillimit;
- Të kërkojë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe të drejtimit për subjektin që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të kërkojë nga punonjësit e subjektit të audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklaratat dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat drejtuesi i subjektit të audituar ka vënë shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që kanë lidhje me auditimin e brendshëm të subjektit;
- Të ndjekë, në mënyrë periodike, edukimin e përditësuar dhe trajnimin e vazhdueshëm të detyrueshëm, sipas kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), për funksionet e veçanta që ushtron, si dhe në fusha të tjera brenda shërbimit publik;

- Ti paraqesë kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur çmohet se për shkaqe të argumentuara cënohet besueshmëria dhe cilësia e auditimit (raste të konfliktit të interesit të parashikuara në Kartën e Auditimit të Brendshëm, si edhe legjislacionin e auditimit të brendshëm).
- Monitoron respektimin e afateve dhe periudhës kohore të përcaktuara në Programin e Auditimit.

### **Paraqitja e dokumentave**

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës **19.06.2026**, në adresën elektronike [hr@kesh.al](mailto:hr@kesh.al) Departamentin e Burimeve Njerëzore këto dokumenta:

- ✓ Kërkesën për aplikim
- ✓ Curriculum Vitae
- ✓ Çertifikatë përbërje familjare
- ✓ Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara
- ✓ Çertifikata kualifikimi (në rast se ka)
- ✓ Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit
- ✓ Dëshmi e gjendjes gjyqësore dhe mjekësore

**Mirald Hekuri**

Departamenti i Burimeve Njerëzore  
Drejtor